

INFORMATIVË MBI TRAJTIMIN E TË DHËNAVE PERSONALE

në bazë të nenit 13 të Rregullores BE n. 679/2016

1. Lënda

Kjo informativë (relacion informues) lëshohet në përputhje dhe në bazë të nenit 13 të Rregullores BE n. 679/2016 (“GDPR”) në mënyrë që t’ju informojë se, në lidhje me zbatimin e linjave udhëzuese të lëshuara nga Presidenca e Këshillit të Ministrave, nga Rajonet në fjalë dhe nga Autoritetet shëndetësore kompetente, për të kufizuar infektimin nga virusi COVID-19 (i ashtuquajtur “Coronavirus”), përpara dhe gjatë imbarkimit në anijet e Adria Ferries; do të trajtohen të dhënat personale që kanë lidhje me ju, gjithashtu që janë të përshtatshme për të zbuluar gjendjen tuaj shëndetësore, duke respektuar normativën e aplikueshme dhe të drejtat tuaja.

Trajtimi i të dhënave tuaja personale bëhet përpara se të hypni në bord, me anën e plotësimit të një autocertifikimi në formën e një pyetësoi.

2. Titullari i trajtimit

Titullari i trajtimit për të dhënat tuaja personale është Adria Ferries S.p.A. me seli në Lungomare Vanvitelli n. 18, 60121 Ancona (AN). Mund të kontaktoni titullarin në adresën privacy@adriaferries.it.

3. Tipologjia e të dhënave personale të trajtuara, qëllimi dhe baza ligjore e trajtimit

Trajtimi i ka si objekt:

- (i) të dhënat tuaja personale të zakonshme (aty përfshihen potencialisht të dhënat që kanë lidhje me zhvendosjet tuaja);
- (ii) kategori të veçanta të të dhënave personale që ju referohen sipas nenit 9 të GDPR, posaçërisht të dhënat e përshtatshme për të zbuluar gjendjen tuaj shëndetësore.

Trajtimi i të dhënave të tilla është i nevojshëm për arsye të interesit publik, ato identifikohen nga dekreti D.L. 6/2020, siç është integruar nga dekreti D.P.C.M. i datës 23/02/2020 dhe nga ordinancat e lëshuara nga Rajonet e mëposhtme, së bashku me Ministrinë e Shëndetësisë: Lombardia (20/02/2020); Veneto (23/02/2020); Friuli Venezia Giulia (23/02/2020); Emilia Romagna (23/02/2020); Liguria (23/02/2020); Toscana (23/02/2020); Campania (24/02/2020). Ky trajtim është i ligjshëm në përputhje me nenet 6(1), germa c), d), e) e 9(2), germa h) dhe/ose i) i GDPR.

Trajtimi kryhet vetëm për qëllimin e marrjes së masave paraprake, në përputhje me linjat udhëzuese të lëshuara nga Autoritetet kompetente sanitare, qeveritare dhe rajonale për të kundërshtuar përhapjen e infeksionit nga Coronavirus.

4. Modaliteti i trajtimit të të dhënave personale dhe ruajtja përkatëse

Trajtimi kryhet me sisteme informatike dhe/ose manuale. Të dhënat tuaja personale nuk u komunikohen palëve të treta e as nuk do të shpërndahen me mënyra të tjera, përveçse kur është (i) e nevojshme për kontrollimin e infeksionit nga Coronavirus; dhe/ose (ii) kërkohet nga ana ligjore, nga burimet e të së drejtës së rendit dytësor, nga Autoritetet kompetente shëndetësore dhe/ose Autoritetet e caktuara sipas ligjit për kufizimin e infektimit.

Dorëzimi i të dhënave tuaja personale është i nevojshëm për t'ju lejuar të keni akses në anijet Adria Ferries; pa të dhënat tuaja personale, nuk mund të garantohet një akses i tillë.

Trajtimi i të dhënave personale bazohet në çdo rast në respektimin e parimeve të proporcionalitetit dhe nevojave, për këtë arsye nuk do të trajtohen as e do të mblidhen të dhëna personale jo të nevojshme, sipas parimit të ligjshmërisë dhe transparencës dhe duke respektuar kërkesat e përshtatshme të masave të sigurisë.

Të dhënat tuaja personale do të eliminohen pas 30 ditësh nga koha e mbledhjes, përveçse kur e specifikojnë detyrimet e përcaktuara me ligj dhe/ose rregulloret dhe/ose qarkoret e aplikueshme dhe/ose Autoritetet kompetente nuk kërkojnë një afat të ndryshëm për ruajtjen e tyre.

5. Të drejtat e subjekteve të interesuara

Nëse duhet të ketë një shkelje të të drejtave tuaja, mund të bëni një ankesë formale pranë Autoritetit Garantues (neni 77) sipas modaliteteve të përcaktuara në faqen e internetit të Autoritetit në adresën: <https://www.garanteprivacy.it/web/guest/reclamo>, si dhe për të bërë një rekurs gjyqësor (neni 79).

Për ushtrimin e të drejtave tuaja, si dhe për çdo informacion tjetër, mund të drejtoheni në adresën e mëposhtme: privacy@adriaferries.it.

Titullari për trajtimin e të dhënave ka marrë masa për të caktuar një përgjegjës për mbrojtjen e të dhënave ("DPO"). DPO mund të kontaktohet në adresën: dpo@adriaferries.it.